



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 169, Datë 28.06.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER”
SH.P.K NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 10, pikat 1, 3 dhe 7 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/2 prot., datë 21.06.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “NRG Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 prot., datë 12.05.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 31.05.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shkak se në aplikimin e shoqërisë mungonte një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit, në objektin e veprimtarisë së saj nuk ishte i përcaktuar, furnizimi i energjisë elektrike, veprimtari për të cilën kërkon të licencohet, ndaj u vlerësua të mos fillojë procedura për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim, me shkresën nr. 674/1 prot., datë 06.06.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i dhënë udhëzimet përkatëse në zbatim të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar dhe sqaroi shoqërinë se, në rast se do të sillte një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e

vendimit të bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsideroheshin të vlefshme për aplikimin e ri.

- Shoqëria “NRG Power” sh.p.k. brenda afatit 1-mujor, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674/2 prot., datë 10.06.2022, ka riparaqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke depozituar dhe dokumentacionin shtesë.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-së, bazuar në përcaktimet e Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Në zbatim të rregullores, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “g”.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”.

Rezulton se nuk është plotësuar ende dokumentacioni si vijon:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1:

- **gërma “c”** (të dhëna për aplikuesin)
Shoqëria duhet të plotësojë formularin me deklaratat përkatëse në lidhje me njohjen me kuadrin ligjor dhe angazhimin për zbatimin e tij.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë furnizimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.7:

- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).
Shoqëria duhet të depozitojë sistemin IT.
- **gërma “h”** (Të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar).
Shoqëria duhet të paraqesë në ERE informacion në lidhje me klientët dhe energjinë e furnizuar.
- **gërma “i”** (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët).
Shoqëria duhet të paraqesë informacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Në vijim të vendimit të bordit nr. 131/2022, për mosfillimin e procedurës për licencim e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, rezulton se ajo ka depozituar brenda afatit të përcaktuar informacion dhe dokumentacion plotësues, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI